

## PROCESVERBAL

### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**Rikonstruktion i kopështit Hap pas Hapi**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**45214100-1 - Punime ndërtimi për kopështe femijësh, 45210000-2 - Punime ndërtimi,**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**56,544,778** (pesëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavajë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;
- c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 11;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit \_\_\_\_\_

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë referuar nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së tre viteve të fundit financiare, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarisht, por me kohështrirje tre vjecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2019, 2020 dhe 2021 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

**2.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtarët, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementet konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.. Kur oferta paraqitet

nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme

Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë. Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim..

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 - A; NP 3 - B; NP 4 - A; NP 7 - A; NP 12 - A; NS 1 - A; NS 2 - A; NS 4 - A; NS 12 - A; NS 14 - A; NS 18 - A.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

*NP 1 - Punime germimi në tokë.* Ne kete projekt trajtohen germimet ne trupin e rruges dhe kanaleet anesore, ndertimi i mbushjes dhe germimi per strukturat e Themeleve. Germimet dhe mbushjet e nevojshme per krijimin e trupit te rruges, kanaleve kulluese anesore, akseset, kalimet dhe pjerresite dhe te tjera si keto, si edhe per ndertimin e strukturave, duhet te behen ne format dhe dimensionet e treguara ne vizatimet perkatese, vetem ne rastet e ndryshimeve te mundshme qe Punedhensesi do te adoptoje, dhe te gjitha kostot qe sjellin keto lloj punimesh do te jene ne ngarkim te Kontraktorit, duke perfshire edhe ato per punimet mbrojtese apo te perforcimeve te mundshme, te gjitha keto duhet te jene llogaritur nga ai ne vendosjen e çmimit per njesi. Pjerresite e germimeve dhe dhe mbushje duhet te kryhen sipas pjerresise se pershtatshme sipas natyres dhe karakteristikeve fiziko-mekanike te formacioneve

Konsiderohen germimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara meçfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, eshte me e vogel se 20 milion leke.*

*N.P 3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.* Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e madhe se 21 milion leke dhe me e voges se 50 milion leke.*

*NP 4 - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.* Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderrur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushtojtë që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*N.P 7 - Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.* Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjiellat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*NP 12 - Punime të inxhinierisë mjedisore.* Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësisë të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

*N.S –1 Punime për prishjen e ndërtimeve.* Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.* Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*NS 4 – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.* Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.*

*NS 12 - Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.* Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.*

*NS 14 - Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.* Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.*

*NS 18 - Punime topogjeodezike.* Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Sic përcaktohet në tabelën që i bashkangjitet këtij procesverbali.

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial / ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektronik, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier topograf/markshajder dhe 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik.. Stafit i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Korrik - Shtator 2022 si dhe të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 të kriterëve teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të

mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Konkretisht 1 (një) inxhinier ndërtimi, I cili nevojitet për zbatimin e punimeve të ndërtimit object I kontratës. Kryesisht punime prishje, punime shtrim me pllaka, punime suvatimi, punime të terracës etj. 1 (një) inxhinier elektronik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve Vendosje Rack Data Pajisje, Rrjeti Kompjuterik & CCTV. 1 (një) inxhinier elektrik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve elektrike. 1 (një) inxhinier hidroteknik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve hidrosanitare. 1 (një) inxhinier mjedisi, për ruajtjen e raporteve midis zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe ruajtjes së mjedisit, kryesisht në përdorimin e materialeve të padëmshme mjedisore, menaxhimin e mbetjeve ndërtimore, lëvizjen e orientuar të mjeteve në rrugë etj. 1 (një) inxhinier mekanik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve mekanike. 1 (një) inxhinier topograf/markshajder të nevojshëm për matjet dhe piketimet. 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik është I domosdoshëm sepse për ndërhyrjet që do të bëhen, është kryer një studimit I thelluar gjeologjik dhe për implementimin e punimeve që lidhen me këtë studim.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për përdorimin e materialeve hidroizoluese.

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente për 2 (dy) teknikë ndërtimi/specialist ndërtimi, 3 (tre) elektrikistë, 3 (tre) hidraulikë, 5(pesë) muratorë/suvatues, 2 (dy) karpentierë, 2 (dy) hekurkthyes, 2 (dy) persona te pajisur me certifikaten per punimet ne lartesi.. Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë gjatë periudhës Korrik - Shtator 2022. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 3 (tre) manovratorë/eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.4.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm.

**Argumentim:** Kërkesa per e mesiperme eshte detyrim ligjor bazuar ne VKM nr. 108, datë 9.2.2011, i ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.07.2015. Referuar akteve ligjore te mesiperme Inspektoriatit Shteteror te Punes sqaron që pavaresisht percaktimeve te pikes 6 te VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, cdo subjekt duhet te kete mjekun e shoqerise pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve.  
<https://inspektoriatipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

**2.3.5.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 45 (dyzet e pesë) punonjës punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Korrik - Shtator 2022, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
- Listëpagesat për periudhën Korrik - Shtator 2022, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre“, sic përcaktohet në tabelën që i bashkangjitet këtij procesverbali.

**2.3.6.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 3 (tre) kamion vetëshkarkues, me kapacitet mbajtës  $\geq 10$  ton, 3 (tre) kamion/kamionçinë, me kapacitet mbajtës 1 – 7.5 ton, 1 (një) kamion me vinc, me kapacitet mbajtës  $\geq 5$  ton, 1 (një) ekskavator, 1 (një) fadrome, 1 (një) vinc kullë ose autovinc me krah horizontal mbi 40 ml (shoqeruar me skede teknike), 1 (një) autobetoniere, 1 (një) autopompë betoni, 1 (një) autobot uji, 1 (një) rimorkiator, 2 (dy) pompë suvatimi, 2 (dy) vibrator betoni, skele inventar  $\geq 1,000$  m<sup>2</sup> dhe panele armature betonimi  $\geq 100$  m<sup>2</sup>.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore..

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument te vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet

teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre“. Konkretisht 3 (tre) kamion vetëshkarkues, me kapacitet mbajtës  $\geq 10$  ton, 3 (tre) kamion/kamionçinë, me kapacitet mbajtës 1 – 7.5 ton,, sasia e mbetjeve ndërtimore të llogaritura në preventivin me të njëjtin object është mbi 650 m<sup>3</sup> të cilat duhet të transportohen deri në 5 km referuar manualit të punimeve të ndërtimit. Megjithatë në bazë të ligjit “Për mjedisin” mbetjet ndërtimore duhet të hidhjen vetëm në vendgrumbullimet e miratuara nga institucioni përkatës. Aktualisht Bashkia Kavajë nuk ka vendgrumbullim të mbetjeve ndërtimore, vendgrumbullimi më i afërt është ai i Sharrës. Duke marrë parasysh të gjitha këto është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të ketë apo ti vihen në dispozicion kamionët vetëshkarkues me kapacitet dhe sasinë e përcaktuar mësipër. Këto mjete janë të nevojshme për transportin e material që shkarkohen me fuqi punëtore dhe që aksesojnë në rrugica. 1 (një) kamion me vinc, me kapacitet mbajtës  $\geq 5$  ton, të domosdoshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve që nuk shkarkohen me fuqi punëtore. 1 (një) ekskavator, të domosdoshëm për zbatimin e punimeve të gërmimit të llogaritura në masën 650 m<sup>3</sup>. 1 (një) fadrome, e domosdoshme për zbatimin e punimeve të prishjes së strukturave prej betony dhe guri sic parashikohet në preventivin me të njëjtin object. 1 (një) vinc kullë ose autovinc me krah horizontal mbi 40 ml (shoqëruar me skede teknike), sic parashikohet në preventivin me të njëjtin object zërat e punimeve me numër analize të manualit të punimeve të ndërtimit 2.166, 2.167, 2.264, 2.267/b, 2.310/1, 2.334, 2.264 etj. 1 (një) autobetoniere, e domosdoshme për zbatimin e punimeve të betonit sic parashikohet në preventivin me të njëjtin object. 1 (një) autopompë betony, e domosdoshme për zbatimin e punimeve të betonit sic parashikohet në preventivin me të njëjtin object. 1 (një) autobot uji, 1 (një) rimorkiator, për transportimin e mjeteve të rënda që nuk lëvizin dhe nuk lejohet të lëvizin vetë në rrugë. 2 (dy) pompë suvatimi, të domosdoshëm për zbatimin e punimeve të suvatimit sic parashikohet në preventivin me të njëjtin object. 2 (dy) vibrator betoni, skele inventar  $\geq 1,000$  m<sup>2</sup> dhe panele armature betonimi  $\geq 100$  m<sup>2</sup> të domosdoshëm për zbatimin e punimeve të suvatimit, përforcimit dhe të betonimit të shtrukturave monolite të betonit sic parashikohet në preventivin me të njëjtin object.

2.3.7. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

1. Operatorët ekonomikë, duhet kenë 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.
2. Operatorët ekonomikë, duhet kenë 1 (një) fabrikë për prodhimin e inerteve, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.
3. Operatorët ekonomikë për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin kontratë/marrëveshje të vlefshme me një laborator, për testimin dhe analizat e betonit, i akredituar nga ana e Drejtorisë së Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
4. Për pajisje hidrosanitare dhe hidraulike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisje hidrosanitare dhe hidraulike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në cdo rast duhet të vërtetohet lidhja midis furnitorit dhe produktit të certifikuar.



5. Për pajisje elektrike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi / furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisje elektrike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në cdo rast duhet të vërtetohet lidhja midis furnitorit dhe produktit të certifikuar.

6. Për pajisje hidroizoluese dhe termoizoluese. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun/fragmente përkatës. Pajisje hidroizoluese dhe termoizoluese duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në cdo rast duhet të vërtetohet lidhja midis furnitorit dhe produktit të certifikuar.

7. Per dyer, dritare dhe vetrata. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe skeda teknike perkatese.

8. Per hekurin. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi.

9. Për bojrat hidroplastike, grafiato, koll dhe pllakat. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun/fragmente përkatës.

**Argumentimi:** Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet kryesore që nevojiten për realizimin e punimeve të ndërtimit objekt i kontratës.

**2.3.8.** Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001-2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
2. ISO 14001-2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.
3. ISO 45001-2018 (Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe shëndetit të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Nr.	Nr Analize	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia	Orë pune / njësi	Gjithsej	Licenca
<b>I</b>	<b>PUNIME PER SONDAZHE DHE IDENTIFIKIM E DEMTIMEVE</b>						
1	An-01	Sondazhe në muraturë tulle	copë	20.00	2.244	44.88	NP 3
2	An-02	Sondazhe në soleta	copë	20.00	1.760	35.20	NP 3
<b>Shuma I</b>						80.08	

<b>II PUNIME PRISHJE DHE ÇMONTIMI</b>							
1	analize	Cmontim - heqje dritare + transport	m2	58.00	0.610	35.38	NS 1
2	analize	Cmontim - heqje dyer + transport	m2	40.00	0.950	38.00	NS 1
3	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim + transport mbeturinash+ muret e rrethimit	m3	30.00	2.200	66.00	NS 1
4	analize	Prishje suva + transport	m2	1850.00	0.725	1,341.25	NS 1
5	2.426/3	Prishje shtresa betoni + transport	m3	60.00	18.800	1,128.00	NS 1
6	analize	Prishje shtresa pllakash + transport mbeturinash	m2	500.00	1.690	845.00	NS 1
7	analize	Prishje hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	300.00	0.940	282.00	NS 1
8	analize	Prishje veshje me pllake majolike	m2	95.00	1.130	107.35	NS 1
9	analize	Prishje plintuse h = 10 cm	ml	350.00	0.146	51.10	NS 1
10	analize	Heqje e linjave elektrike+transport	dp	10.00	8.000	80.00	NS 1
11	analize	Heqje e rrjeteve hidrosanitare +transport	dp	10.00	8.000	80.00	NS 1
12	analize	Prishje cati me konstruksion druri derrase dhe heqje tjegulla + transport	m <sup>2</sup>	150.00	1.630	244.50	NS 1
13	An-9	Sonda në soleta per kalim rrjeteve te instalimeve	copë	30.00	1.500	45.00	NS 1
<b>SHUMA II</b>						<b>4,343.58</b>	
<b>II PUNIME BETONI DHE BETONARMEJE , SHTRESA</b>							
1	2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m	m <sup>3</sup>	17.60	20.600	362.56	NP 3
2	2.117/1a	Kollona b/a monolite C 20/25	m <sup>3</sup>	10.20	20.600	210.12	NP 3
3	2.262/4a	Trare, bazamente themeli b/a C 20/25 dhe shtrese bazamenti	m <sup>3</sup>	90.00	3.460	311.40	NP 3
4	analize	Soleta te parapergatitura me tulla me 6 vrime C 20/25, h = 25+5 cm	m <sup>2</sup>	310.00	2.000	620.00	NP 3
<b>SHUMA III</b>						<b>1,504.08</b>	
<b>III PUNIME RIAFTËSIMI STRUKTOROR</b>							
1	An-03	Tipi 1 - Riparimi i fugave sizmike	ml	20.00	3.520	70.40	NP 3
2	An-04	Tipi 2 - Shtangësimi i mureve mbajtese me betonim me pompe dhe armim	m2	150.00	1.200	180.00	NP 3
3	An-07	Perforcim mure me material FRP ( Fiber reinforced polymers)	m2	50.00	2.000	100.00	NR 3
4	An-05	Tipi 5/2 - Shtangësimi i mureve mbajtës, përforcimi i hapjeve të mureve	copë	2.00	2.000	4.00	NP 3
5	An-06	Tipi 5/3 - Shtangësimi i mureve mbajtës, përforcimi i hapjeve të mureve	copë	3.00	2.000	6.00	NP 3
<b>SHUMA IV</b>						<b>360.40</b>	
<b>IV PUNIME ARMATURE ÇELIKU</b>							
1	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	7.50	60.000	450.00	NP 3
2	2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	13.00	42.000	546.00	NP3
3	2.181	Konstruksione metalike te perbera	ton	8.50	48.000	408.00	NP 3
<b>SHUMA V</b>						<b>1,404.00</b>	
<b>SHUMA I-V</b>						<b>7,692.14</b>	
<b>TOTALI PUNIME KONSTRUKTIVE</b>						<b>7,692.14</b>	
PUNIME RIFINITURE							
Nr	Nr. Analize	Emertimi i Punimeve	njesia	sasia			
<b>I Punime murature</b>							
1	2.71/2	Mur me tulle të lehtësuara dopio deri 3m me llaç përzier M25, t=20cm	m3	62.0	18.600	1,153.20	NP 3
2	2.86	Mur tulle ndares me 6 vrime, t=12cm, h~3m, llaç perzier M15	m3	20.0	14.000	280.00	NP 3
<b>SHUMA I</b>						<b>1,433.20</b>	
<b>II Punime shtresa, Dysheme e Tavani</b>							

1	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 niveluese dysHEME	m3	53.0	8.600	455.80	NP 3
2	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat importi	m2	245.0	2.000	490.00	NP 3
